



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3128/7 prot

Datë 20.11.2024

V E N D I M
Nr. 1654/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura”, me fond limit 110,154,899.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.11.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A.

Modifikimi i dokumenteve të tenderit, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe me adresë: Njësia Administrative 11, Koder - Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A me adresë:

Rr. “Reshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.10.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura”, me fond limit 110,154,899.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.11.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 28.10.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4718 dhe me nr. 3128/2024 protokoll, i operatorit ekonomik “Klame” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Më datë 06.11.2024, me shkresën nr. 1787/6 prot., datë 04.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3128/2 prot., datë 06.11.2024, është ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, bashkëlidhur së cilit gjendet vendimi i KSHA nr. 1787/5 prot., datë 01.11.2024 për trajtimin e ankesës së ankimuesit.

II.5. Referuar vendimit të KSHA-së më sipër rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK dhe e ka njoftuar atë dhe KPP se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

II.6. Me shkresën nr. 2151 prot., datë 13.11.2024 me objekt “ Kërkesë për përsheptimin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara nga OBP sha” autoriteti kontraktor ka paraqitur kërkesën për përsheptimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Më datë 06.11.2024, me shkresën nr. 1787/6 prot., datë 04.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3128/2 prot., datë 06.11.2024, është ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, bashkëlidhur së cilit gjendet vendimi i KSHA nr. 1787/5 prot., datë 01.11.2024 për trajtimin e ankesës së ankimuesit, i cili ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III.1.2. Referuar vendimit të KSHA-së më sipër rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK dhe e ka njoftuar atë dhe KPP se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës konkretisht duke pranuar: *“11.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” shpk mbi modifikimin e kriterit të veçantë të përcaktuar në Dokumentat e Tenderit, pika 2.3.9. dhe të Kapacitetit teknik, KSHA vëren se:*

Në dokumentat e tenderit, pika 2.3 Kapaciteti teknik, nënpika 9 është përcaktuar se “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë:

Kamion vetëshkarkues

kapaciteti mbajtës minimumi 3.5 (tre pikë pesë) ton 3 copë Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse noteriale të qerave. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes”

Në procesverbalin e datës 16.10.2024 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues: “Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6 d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Bazuar në analizen teknike duke pasur parasysh punimet që do të kryhen, transporti i materialeve të kërkuara të cilat janë të konsiderueshme kërkohet dhe numri i mjeteve të sipërpërmendura.”

Komisioni i Shyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se Zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (nakineritë/automjete), në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

KSHA gjykon se përcaktimi në kriterin e sipërcituar të llojit të kamionit vetëshkarkues është një lapsus dhe si i tillë do të modifikohet nga autoriteti kontraktor duke hequr fjalën “vetëshkarkues”,
.....

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron pjesërisht.”

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e

pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.1.5. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK për pikën 2.16. “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera” të dokumenteve të tenderit për të cilin kërkon që: “kerkojme heqjen e kufizimit mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera që kanë të bëjnë me: “Xhiron, licencën profesionale, numrin e punonjesve dhe stafit” si teresisht në kapercim të ligjit të prokurimeve publike” KPP vëren se,

III.2.1. Në pikën 2.16 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

x

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ndalohet mbështetja për: vërtetim për xhiron vjetore, dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, licencën profesionale të shoqërisë dhe lejen mjedisore si dhe numrin e punonjesve dhe stafin pasi janë elemente të domosdoshëm që AK të krijojë bindjen se OE e realizon me sukses kontratën.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.5. Në nenin 84 pika 1,3 dhe 6 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.”

III.2.6. Neni 40, pika 3, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

III.2.7. Në nenin 90 pika 1 dhe 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

6.Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.”

III.2.8. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

[...] Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”:

1.Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës Juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2.Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetei në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës,
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër. '

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/entit kontraktor mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspecteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderi e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njekohesisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

Nëse do të analizojmë në mënyrë analitike këtë nen të VKM-së, në pikën 1 të tij ai përshkruan fushat në të cilat një OE mund të mbështetet sic janë:

1. kapacitet ekonomike e financiare,
2. aftësitë teknike ose profesionale.

Tek kapacitet ekonomike e financiare përfshihen ato kritere të DST të cilat kanë të bëjnë me sigurinë ekonomiko-financiare që AK kërkon nga OE-të pjesëmarrës që të realizojnë kontratën, sic janë kërkesat për xhiron, bilancet etj.

Tek kapacitetet teknike ose profesionale përfshihen ato kritere të DST të cilat kanë të bëjnë me sigurinë teknike që AK kërkon nga QE-të pjesëmarrës që të realizojnë kontratën, sic janë kërkesat për eksperiencën e ngjashme, stafin, licencat profesionale, makineri-paisje etj.

Pra literalisht VKM parashikon që mbështetja e OE ofertues tek subjektet e tjera bëhet për këto aspekte.

Më tej, pika 6 parashikon se autoritetifenti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit. Pra ligjvënësi i ka lanë AK-së të vendosë se nga aspektet e vendosura në pikën 1 të VKM, cilat kërkon që të realizohen nga vetë OE ofertues, gjë që ka bërë dhe Njësia e Prokurimit më këtë procedurë. Dhe argumentimi është bërë shprehimisht: pasi janë elemente te domosdoshem që AK te krijojë bindjen se OE e realizon me sukses kontratën.

Bazuar në vlerën e fondit limit dhe rëndësisë që ky projekt ka Njësia e Prokurimit ka vendosur se OE nuk mund të mbështetet në kapacitete të subjekteve të tjera për këto elemente.

Pra, referuar kriterit të sipërcituar, Autoriteti Kontraktor rezulton të jetë kufizuar vetëm në ndalesën e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për vërtetim për xhiron vjetore, dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, licencën profesionale të shoqërisë dhe lejen mjedisore si dhe numrin e punonjësve dhe stafin pasi janë elementë të domosdoshëm që AK të krijojë bindjen se OE e realizon me sukses kontratën, ndaj Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se kriteri i sipërcituar në pikën 2.16 të Dokumenteve të Tenderit nuk duhet të ndryshojë.

Nga natyra e prokurimit në fjalë OE-të mund të realizojnë forma të tjera bashkëpunimi sic janë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë ndaj vlerësojmë se kjo kërkesë e AK-së, kur LPP ja lejon dhe nuk kufizon pjesëmarrjen e OE-ve është e saktë dhe pretendimet e OE ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme si dhe për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt i kontratës) nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar

aspektet në të cila nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të mbëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. KPP gjykon, se ligjvënësi përmes *lex specialis* por edhe rregullat e prokurimit publik që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për t'u mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në diskrecionin e autoriteti kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofruesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit. Fakti që ligji dhe rregullat e prokurimit publik i kanë dhënë diskrecionin autoritetit kontraktor që të vendosë kufizime mbi aspekte të caktuara të mbështetjes në subjektet e tjera nuk do të thotë që ato të bëhen pa një argumentim të saktë dhe të detajuar që justifikon kufizime të tilla. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar në asnjë pikë pse nuk ka lejuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera pikërisht për *xhiron, licencen profesionale, numrin e punonjësve dhe stafin* të cilët në rastin konkret janë objekt i ankesës së operatorit ekonomik "Klame" SHPK. Vetë ligjvënësi përmes ligjit për prokurimin publik por edhe në rregullat e prokurimit publik ka kufizuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për *aspekte kritike* ku autoriteti kontraktor në rastin konkret ka dështuar të argumentojë në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim pse elementët më sipër përbëjnë aspekte kritike në raport me aspekte të tjera për të cilat ka lejuar mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera. Komisioni gjykon se një prej dallimeve esenciale ndërmjet kritereve të kualifikimit me kriteret për shpalljen e kontratës fituese është se kriteret e kualifikimit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi në të kundërt oferta e tyre refuzohet, ndërsa kriteret për shpalljen e kontratës fituese kanë karakter vlerësues për të evidentuar ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi dhe nuk përbëjnë shkak për kualifikimin/skualifikimin e ofertave. Gjithsesi, bazuar në nenin 87 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni gjykon se, pavarësisht se kriteret për shpalljen e kontratës fituese janë me karakter të ndryshëm vlerësimi nga kriteret e kualifikimit, parimi për hartimin e tyre është i njëjtë. Pra, për hartimin e të dy kategorive të kritereve, autoritetet kontraktore duhet të kujdesen që këto kritere të jenë në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës që prokurohet, të jenë të qarta, të sakta, të mos krijon konfuzion, si dhe të garantojnë një konkurrencë efektive duke shmangur çdo lloj kufizimi të panevojshëm. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar kërkesën e cila nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për *xhiron, licencen profesionale, numrin e punonjësve dhe stafin* të cilët në rastin konkret janë objekt i ankesës së operatorit ekonomik "Klame" SHPK duke qenë më i qartë dhe të mirëargumentojë hartimin e saj për kufizimet më sipër duke pasur parasysh parashikimet e nenit 90 pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar lidhur me aspektet kritike ose në të kundërt të heqë kufizimet objekt i ankesës lidhur me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Sa më lart, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK për pikën 2.2.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkon që: “[...] Ne kete kuptim, autoriteti kontraktor duhet te garantoje respektimin e parimit te trajtimit te barabarte si te biznesit te madh qe e arrijne xhiron sa fondi limit ashtu edhe biznesin qe nuk e arrin dot kete xhiro sa fondi limit por qe ligji i jep mundesi te permbushi qofte edhe nje xhiro me te vogel se fondi limit. Ne kete kuptim ligji ia jep kete te drejte autoritetit kontraktor dhe nuk ka arsye ligjore pse mos ta reduktoje xhiron duke kerkuar 40-50% te fondit limit te prokuruar. Nga sa me siper, kerkojme qe bazuar ne lejimet ligjore te referuara me detaje me siper, te behet reduktimi i vleres se xhiros ne 40% te fondit limit, pasi kjo do e bente garen e prokurimit me te hapur dhe do te lejonte bizneset e vogla ne gare.” KPP vëren se,

III.3.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.1, është përcaktuar si më poshtë:

“1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Në nenin 43, pika 2 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

III.3.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar: “**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; , nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalohë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.”

III.3.7. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] KSHA gjykon se, vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga Njësia e Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera

e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit publik si më sipër cituar, ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Pra njësia e prokurimit, ka vendosur një vlerë më të ulët se maksimumi që ligjvënësi përcakton për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe e ka argumentuar këtë kriter duke mos lënë shkak për ndryshimin e tij. Arsyetimi i OE ankimues për nxitjen e biznesit të vogël nuk qëndron pasi vetë Fondi Limit i kësaj procedure indukon një xhiro më të lartë se ajo e bizneseve të vogla apo të mesme dhe OE-të afertues mund të realizojnë forma të tjera bashkëpunimi sic janë Bashkimi i) Operatorëve Ekonomikë ndaj vlerësojmë se kjo kërkesë e AK-së, kur LPP ja lejon dhe nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, referuar pretendimit të ankimuesit dhe mbështetur në frymën e Ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 2 “Qëllimi i ligjit”, gërmat c), ç), d), Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe përfitim të mallit cilësor, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se kriteri i sipërcituar në pikën 2.2.1 të Dokumenteve të Tenderit nuk duhet të ndryshojë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me

dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.9. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK të paraqitura në ankesë për kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën e xhiros së është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 43 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe financiar kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit por vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:*a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.* Nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar në lidhje me vlerën e xhiros së kërkuar për vitet 2021,2022 dhe 2023 është në përputhje me parashikimet e nenit 43 pika 2/ a të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar pasi jemi në rastin e procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar dhe në rastet e kësaj procedure vlera e xhiros minimale që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, çfarë do të thotë se autoriteti kontraktor në varësi të, kompleksitetit dhe përmasave të kontratës për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar mund të kërkojë vlerën e xhiros më të vogël ose baraz me dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalohet këtë vlerë. Në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit pra duke kërkuar një vlerë më të ulët të xhiros nga ajo që parashikon neni 43 pika 2/a duke argumentuar në mënyrë të qartë në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim hartimin e kriterit e konkretisht duke u shprehur se: *“Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.* Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është

konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.” Sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor e ka hartuar kriterin në përputhje me parashikimet e nenit 43 pika 2 të aktit nënligjor më sipër dhe si rrjedhim pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Klame” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Klame” SHPK për pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkon që: *“[...] Ne kete kuptim, me qellim qe autoriteti kontraktor te marre siguri se operatoret ekonomike mund te realizojne edhe zerat e punimeve, mjaftojne kerkesat per: - Inxhinier ndertimi 1, - Inxhinier Elektrik 1, Elektracist 2, Suvatues 1 dhe Saldator 3, per pasoje kerkojme heqjen e kerkeses edhe per licencen profesionale te shoqerise e cila perfshin kategorite e meposhtme: a. NP-3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. b. NS-4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese c. NS – 14 B Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, Tv etj.”* KPP vëren se,

III.4.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.3, është përcaktuar si më poshtë:

3. *Operatori ekonomik (i profilit “ Ndertim”) duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*
 - a. *NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.*
 - b. *NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese*
 - c. *NS – 14 B Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, Tv etj.*

Shenim: Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike licencat do te paraqiten perkatesisht sipas fushes se veprimtarise.

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 *“Parime të përgjithshme”* të ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.4.3. Neni 21 pika 1 *“Autoriteti ose enti kontraktor”* i ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.5. Në nenin 40 pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

III.4.6. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: “Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kategoritë e kërkuara të licencave janë kërkuar bazuar në zërat e përcaktuar në preventivin e punimeve si psh.veshje muri me MDF, Vetratë xhami i temperuar me profile alumini 5cm, me dy dyer xhami me gjerësi 90 cm dhe lartësi 230 cm, Montim Ndricuesish profil I varur dhe spote ND3-ND6, Riparime, prerje dhe saldim profila metalike (helmetat + predhat/gezhajat + element avioni) etj.”

III.4.7. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] Sa më sipër, KSHA konstaton se zërat e mësipërme të punimeve janë përcaktuar në preventiv nga projektuesi, i cili i është referuar këtyre punimeve si punime ndërtimi, të shoqëruara me numrat e analizave përkatëse sipas Manualit të punimeve të ndërtimit si dhe analizave jashtë listës së tij. Në këto kushte, KSHA gjykon se kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik,

janë vendosur në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen gjatë zbatimit të kontratës objekt prokurimi. Konkretisht kategoritë e licencës i referohen rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave civile e industriale, veshjes së fasadave, punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami, rifiniture të natyrës teknike ndërtuese dhe impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. Rerefuuar sa më sipër, KSHA gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DT nuk do të ndryshojë pasi, është i mbështetur në LPP, RRPP dhe udhëzimin nr. 2 për zbatimin e punimeve të ndërtimit sa i takon preventivit të ndërtimit të hartuar nga projektuesi sipas kërkesës së autoritetit kontraktor përfitues dhe publikuar në SPE nga autoriteti kontraktor prokurues. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.”

III.4.8.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për heqjen e licencave profesionale të shoqërisë të përcaktuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit , Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoriteti kontraktor për licencat të kategorive të kërkuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit pasi: *së pari* nga verifikimi i përmbajtjes së dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor këto licenca i ka kërkuar për operatorë ekonomikë të profilit ndërtim, dhe *së dyti* referuar preventivëve të ngarkuar në SPE si pjesë integrale e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor i ka ndarë në dy llojë; preventiv i mobilimit (ku bëjnë pjesë zëra të natyrës mall) dhe preventim i punimeve (ku bëjnë pjesë zëra të natyrës punë). Në këtë kuadër KPP vëren se duke ju referuar të dhënave kryesore të procedurës së prokurimit objekt ankimi, vërtetë është përcaktuar tipit i kontratës “mallra”, por nga ana tjetër referuar zerave të preventivit të punimeve, jemi para një kontrate të përzier me mallra dhe punime ku mallrat zënë një peshë më të madhe në raport me punimet çfarë ka përcaktuar edhe tipin e kontratës, por nuk mund të anashkalohet fakti që referuar

preventivi të punimeve rezultojnë zëra të tij që lidhen me kategoritë e licencave profesionale që duhet të disponojë subjekti që duhet të kryejë ato punime. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit “*që autoriteti kontraktor të marrë siguri se operatorët ekonomik mund të realizojnë edhe zerat e punimeve mjaftojnë kërkesat për: inxhinier ndërtimi 1, inxhinier elektrik 1, elektrikist 2, suvatues 1 dhe saldator 3 kërkojmë heqjen e kërkesës edhe për licencën profesionale të shoqërisë e cil përfshin kategoritë mëposhtme...*” Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij, duke e lidhur nevojën për stafin e përmendur më sipërm në lidhje të drejtpërdrejtë me licencat e kërkuar dhe në këtë kuadër nuk mund të shikohet prezenca e stafit me profilet e kërkuara më sipër si plotësues i tyre. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike, ka arritur të argumetojë nevojën për kategoritë e licencave të tilla profesionale për subjektin, duke e lidhur me zërat e përcaktuar në preventivin e punimeve si psh. veshje muri me MDF, Vetratë xhami i temperuar me profile alumini 5cm, me dy dyer xhami me gjerësi 90 cm dhe lartësi 230 cm, Montim Ndricuesish profil I varur dhe spote ND3-ND6, Riparime, prerje dhe saldime profila metalike (helmetat + predhat/gezhojat + element avioni) etj. Në këtë mënyrë, KPP gjykon, se kërkesat për licencat profesionale të shoqërisë të përcaktuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit janë proporcionale me objektin e prokurimit dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për realizimin e qëllimit dhe përmbushjen me sukses të kontratës.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK për pikën 2.3.7 dhe 2.3.8 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkon që: “[...] *kerkojme ndryshimin e kriterit duke kërkuar që punonjësit të figurojnë të siguroar në listepagesat e shoqërisë pa vene si kufizim që ata të figurojnë në të tre muajt por mjafton në muajin e fundit.*

.....

Kërkojmë uljen e numrit të punonjësve nga 45 në minimalisht 20 punonjës” KPP vëren se,

III.5.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.7 dhe 2.3.8, është përcaktuar si më poshtë:

7. *Te gjithë punonjësit e mesiperm duhet të figurojnë në e-sig-et e 3 (tre) muajve të fundit*
8. *Numri minimal i punonjësve duhet të jete 45 (dyzet e pese) në e-siget 3 (tre) muajve të fundit.*

Shenim: Në rastin e BOE, punonjësit do të plotësohen në mënyrë të përbashkët sipas objektit të veprimtarisë pra nëse një OE ka objekt mobilerine do të mbulojë punonjësit e mobilerisë, nëse ka objekt ndërtimit do të plotësojë punonjësit e ndërtimit. Te gjithë anëtarët e BOE duhet të plotësojnë kriteret për punonjësit se bashku. Kjo do të përcaktohet edhe në formularin e vetedeklarimit, ku secili anëtar i BOE duhet të deklarojë se cilet punonjës disponon.

III.5.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.5.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.5.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.5.5. Neni 40, pika 3, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.5.6. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar:

“Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 pika 6/ç nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që autoriteti kontraktor të krijojë besueshmëri dhe siguri në kapacitetet që operatorët ekonomikë kanë për realizimin e projektit objekt prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 pika 6/ç nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Duke pasur parasysh natyrën e punimeve dhe të mallrave të cilat do të prodhohen dhe do të montohen për këtë procedurë prokurimi fuqia punëtore është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë bazuar në vëllimin e punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve në zbatim të VKM Nr 629 datë 15.07.2015 (i ndryshuar) , Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Praktikisht : Vëllimi i punimeve në leke: Pagën orare: orë/ditë: ditë pune/muaj: afatin kohor të punimeve = Nr i punëtorëve.

Punonjësit e mësipërm kërkohet që duhet të figurojnë në e-sig-et e 3 (tre) muajve të fundit për të krijuar autoriteti kontraktor besueshmëri dhe siguri në kapacitetet që operatorët ekonomikë kanë për realizimin e projektit objekt prokurimi..”

III.5.7. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këto pretendime KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] Komisioni i Shyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makincritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (fuqinë puntore), në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

KSHA gjykon se kriteri i sipërcituar është në përputhje me objektin e kontratës dhe dispozitave ligjore për prokurimin publik, si dhe është e nevojshme përmbushja e tij prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në mënyrë që autoriteti kontraktor të krijojë bindjen se operatori ekonomik fitues do të mundësojë realizimin e kontratës në kohë dhe cilësi. Kërkesa që numri i punëtorëve të figurojnë në e-sig-et e 3 (tre) muajve të fundit është mëse e nevojshme dhe i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen, besueshmërinë dhe garancinë në kapacitetet që operatorët ekonomikë zotërojnë për realizimin e kontratës, Referuar objektit të prokurimit rëndësisë së tij, lojit dhe sasisë së mallit të kërkuar si dhe afatit të lëvrimit sipas grafikut përkatës të përcaktuar në DT, numri i punonjësve minimum i përcaktuar është teper i nevojshëm për realizim e kontratës objekt prokurimi në kohë, standard e cilësi. e kontratë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.”

III.5.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specififikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit që punonjësit të figurojnë të siguar në listepagesat e shoqërisë pa vënë si kufizim që ata të figurojnë në tre muajt e fundit por mjafton muajt e fundit, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.7 me figurimin e punonjësve në e-sig-et e 3 (tre) muajve të fundit është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre, çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës, që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor

si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për 3 (tre) muajt e fundit pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Komisioni gjykon, se e rëndësishme është, që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave, të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, i cili do të përbënte garanci, se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohet në kohë dhe me sukses.

Kriteri sa më sipër, që të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në e-sig-et e 3 (tre) muajve të fundit, nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar, por jo të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën e specifikuar më sipër. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me periudhën kohore të figurimit të punonjësve në formularët e-sig, pasi siç është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional. Sa më lart pretendimi i ankimesit qëndron. Lidhur me pretendimin e ankimesit për uljen e numrit të punonjësve nga 45 në minimalisht 20 punonjës, KPP gjykon, se referuar procesvebalit të hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale, kërkesën mbi një numër të tillë punonjësish, duke u mjaftuar me argumentim në mënyrë narrative, me bazë ligjore të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, por pa një analizë të detajuar se përse është një kërkesë e tillë. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një numër prej 45 punonjësish është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, zërave të preventivit, si dhe kohëzgjatjes së punimeve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e punonjësve të kërkuar, pasi kërkesa për 45 punonjës është e ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke

përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e lartpërmendur, duke ulur numrin e punonjësve, me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK për pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkon që:

“- SE PARI Kerkesa per “4 Marangoz”, “4 Montator prodhime druri” “3 saldatore” jane kerkesa teresisht te paargumentuara teknkisht dhe në mënyrë analitike..... autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke ulur numrin e punonjesve te kerkuar ne proporcion me natyren dhe volumin e kontrates objekt shqyrtimi por nuk duhet te kerkoje me shume se 1 deri ne 2 specialiste.”

- SE DYTI, kerkesa qe per 4 Monatatore prodhiem druri dhe 2 Bojaxhinj per prodhime druri jane kerkesa teresisht te pa bazuara ne ligjin e posacem.....Nisur nga sa me siper siper shoqeria jone gjykon se autoriteti kontraktor duhe te modifikojte kriterin kualifikues duke hequr kerkesen qe oepratori ekonomik ofertues te kete te punesuar ne stafin e tij 4 Monatatore prodhime druri dhe 2 bojaxhinj per prodhime druri...” KPP vëren se,

III.6.1 Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.5 është përcaktuar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit si me poshte:

- Marangoz 4 (kater)*
- Montator prodhime druri 4 (kater)*
- Bojaxhi per prodhime druri 1 (nje)*
- Elektracist 2 (dy)*
- Suvatues 1 (një)*
- Saldator 3 (tre)*
- Shofer 3 (tre)*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dorezoje:

- Kontratë pune e vlefshme*
- diplome/deshmi kualifikimi profesionale sipas legjislacionit ne fuqi, gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.*
- Per shoferet kontrate pune te vlefshme.*

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficiencyn dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor”, i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.6.4. Në nenin 77, pika 1 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Neni 40, pika 3, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet*

të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.6.5. Në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar” është përcaktuar si më poshtë:

Grupi-njësi (Profesioni)

*“Karpentierë/zdrukhëtarë dhe të tjerë të lidhur me to” Kodi i profesionit: 7115
Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Karpentierë/zdrukhëtarë dhe të tjerë të lidhur me të”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.*

Karpentieri dhe zdrukhëtari dhe të tjerë të lidhur me to pret, u jep formë, monton, mirëmban dhe riparon llojet e ndryshme të strukturave prej druri, si dhe ndërton korniza dhe struktura të tjera përforcuese prej druri, materiale metalike apo materiale të tjera. Ata mund të punësohen në kompani të ndryshme me aktivitet ndërtimi, të shërbimeve apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore:

Karpentierë/zdrukhëtarë dhe të tjerë të lidhur me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Analizojnë projektin dhe specifikimet teknike të objektit;*
- b) Bëjnë kontrollin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit të punës;*
- c) Bëjnë sistemimin e materialeve dhe veglave të punës sipas proceseve të punës;*
- d) Respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së punës sipas orientimit të dhënë në objekt;*
- e) Kryejnë matjet dhe prerjet sipas përmasave të përcaktuara në projekt;*
- f) Bëjnë hedhjen e akseve në bashkëpunim me topografin apo specialistin përkatës;*
- g) Bëjnë piktimin dhe armaturën anësore të themelit;*
- h) Bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit;*
- i) Ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike;*
- j) Montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave;*
- k) Kontrollonjë vertikaltetin e armaturës (peshon) me plumbçe;*
- l) Nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit);*
- m) Lagin armaturën para betonimit;*
- n) Ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës;*
- o) Vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara);*

- p) Kryejnë kontrollin përfundimtar të punimeve;
- q) Bëjnë dorëzimin e punimeve, të kallëpeve apo strukturave të tjera tek drejtuesi teknik për të gjitha fazat e punimeve;
- r) Bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura;
- s) Kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës;
- t) Krijojnë, riparojnë dhe montojnë pajisje skenike të funksioneve të ndryshme (film, teatër etj.);
- u) Bëjnë ndërtime, montime, ndryshime dhe riparime të strukturave të drurit në vagonët e trenit, anije, mjete transporti mbi ujë, lundrave dhe mjeteve të tjera transporti;
- v) Kryejnë prerjen, formimin, montimin dhe instalimin e pjesëve të drurit;
- w) Përdorin veglat dhe pajisjet e duhura sipas proceseve të punës (si: sqepar, çekiç, plumbçe, nivel, sharrë elektrike ose dore, metër, vibrator etj.);
- x) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- y) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një karpentier dhe marangoz mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel teknik. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier druri.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

<u>7115.01</u>	<u>Bojaxhi për dru</u>
7115.02	Karpentier
7115.03	Karpentier anijesh
7115.04	Karpentier për ndërtim çatie
7115.05	Karpentier miniere
7115.06	Karpentier për konstruksione

7115.07	<i>Karpentier për mirëmbajtje</i>
7115.08	<i>Karpentier për skela</i>
7115.09	<i>Karpentier për ura</i>
7115.10	<i>Karpentier skene</i>
7115.11	<i>Karpentier teatri</i>
7115.12	<i>Karpentier zdrukthëtar</i>
7115.13	<i>Lakues për dru</i>
7115.14	<i>Marangoz</i>
7115.15	<i>Marangoz anijesh</i>
7115.16	<i>Marangoz avionësh</i>
7115.17	<i>Marangoz dhe montues mobiliesh</i>
7115.18	<i>Marangoz konstruksionesh</i>
7115.19	<i>Marangoz skelash</i>
7115.20	<u>Montues për dru</u>
7115.21	<i>Ndërtues dhe riparues anijesh</i>
7115.22	<i>Punues direktësh druri</i>
7115.23	<i>Punues varkash anijesh me dru</i>
7115.24	<i>Punues varkash druri me motor</i>
7115.25	<i>Zdrukthëtar</i>

III.6.6. Në shtojcën 1 të Urdhërit të Minisitrit të Financave nr. 99, date 25.05.201 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale” është përcaktuar si mëposhtë:

Shtojca 1

Nr.	Kodi i kualifikimit profesional	Emërtimi i kualifikimeve	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me kodet e LKP/ISCO	Niveli në KSHK
1	A-II-21	Teknologji ushqimore	Program: 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës në industrinë ushqimore	8160	2
2	A1-III-16	Teknologji e përpunimit të brumërave	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor i përpunimit të brumërave	7512, 7513, 7514	3
3	A2-III-18	Teknologji e prodhimit të pijeve	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në industrinë ushqimore	7516, 7517	3
4	A3-III-17	Teknologji e përpunimit të qumështit	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në përpunimin e qumështit	7515	3
5	A4-III-18	Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në përpunimin e mishit dhe peshkut/kasap	7511	3
6	A5-III-18	Teknologji e përpunimit të fruta-perimeve	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në përpunimin e fruta-perimeve	7516	3
7	A-IV-18	Teknologji ushqimore	Program: 1 vit studimi për teknik/menaxher i mesëm	Kontrollor cilësie/teknolog ushqimor për mishin	3122	4
8	A1-V-14	Kontroll laboratorik i ushqimit	Program: pas të mesëm deri në 2 vjet	Laborant ushqimor	3119	5
9	B-II-20	Ndërtim	Program: 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Ndërtues	9313	2
10	B1-III-17	Muratim dhe suvatim	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Murator, suvatues	7112 dhe 7123	3
11	B2-III-21	Shttrim pllakash dhe veshje muresh	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Shtgues pllakash	7122	3
12	B3-III-18	Karpentieri, hekurkthim dhe betonim	Program: 1 vit për punonjës të kualifikuar	Karpenter	7115	3

III.6.7. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: **“Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjesit me specialitet e siper-permendura kerkohen ne perputhje te plote me objektin e prokurimit, me konkretisht:

Marangozë dhe montator prodhime druri- pjesa me e madhe e zerave te preventivit lidhet me mobilimin te cilat do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga AK. Profesionistet te cilet kane eksperiencen dhe njohurine teknike per keto veprimtari jane marangozi dhe montuesi i mobiljeve. Këta punonjes kanë nje rol kyc ne zbatimin e kontrates.

Punonjesit e tjere si shoferi dhe punonjesit e thjeshte jane te domosdoshem per transportin dhe punen ndihmese qe do te kryhet pergjate te gjithe proceseve te zbatimit te kontrates.

Elektriçistët janë të nevojshëm për montimin e ndriçimit të përcaktuar në projekt dhe në preventiv. Suvatuesi nevojitet për ndërhyrjen qe do bëhet në muret e Kampusit dhe realizimi i veshjes me MDF.

Saldatori duhet pasi në preventiv përfshihen zërat Riparime, prerje dhe saldim profila metalike (helmetat+predhat/gezhojat+element avjoni), (AU-DY-04) konstruksion metalik i përbërë shkallet auditor, recepsioni-struktura e avjoneve.

Bojaxhi për prodhime druri duhet pasi pjesën më të madhe të preventivit e zë mobilimi dhe për tu realizuar ngjyrat sipas përcaktimeve në projekt është parë e arsyeshme kërkesa për një bojaxhi për prodhimet e drurit.”

III.6.8. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] Referuar skeletkurrikulës për profilin mësimor “Prodhime druri Gjysmë të gatshme” të publikuar në faqen zyrtare te internetit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në pikën 3 “Kompetencat profesionale te nxenesit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli III i KSHK” përcaktohen aftësitë profesionale të nxënësit dhe mundësitë për të ushtruar kompetenca të tjera profesionale në fushën përkatëse.

Sa më sipër, Komisioni i Shyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (staf profesional i trajnuar), në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

KSHA gjykon se kriteri i sipërcituar është në përputhje me objektin e kontratës dhe dispozitave ligjore për prokurimin publik, si dhe është e nevojshme përmbushja e tij prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në mënyrë që autoriteti kontraktor të krijojë bindjen se operatori ekonomik fitues do të mundësojë realizimin e kontratës në kohë dhe cilësi. Sa i takon paralelizmit që ankimesi sjell midis rastit në fjale dhe vendimit 436/2024 date 02.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, KSHA thekson se Profesionet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DT i referohen VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, “Grupi-njësi (Profesioni): “Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm”, Kodi i profesionit: 7522”, ku tek “Shembuj të profesionevepunësimeve të ngjashme që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve” i referohet ndër të tjera edhe kodit të profesionit “7115 Karpentierë/zdrukhëtarë dhe të tjerë të lidhur me të”, Gjithashtu, në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale përcaktohet se kualifikimet Përpunim druri, Mobilieri/tapiceri: Prodhime druri gjysmë të gatshme, Përpunim druri, të cilat i referohen Profesionit sipas LKP (Punëtor i përpunimit të drurit, Mobilier/tapicier, Punëtor për prodhimin e produkteve gjysmë të gatshme, Mobilier/tapicier) që të gjitha i referohen kodit lidhës më LKP “Kodi i profesionit 752”. Referuar sa më sipër, KSHA gjykon se profesionet e përcaktuara nga AK në pikën 2.3.5 të Kapacitetit teknik janë të sakta, duke i'u referuar si Vendimit 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar” edhe Urdhërit Nr. 99, datë 25.5.2021 “Mbi miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”. Gjithashtu numri i përcaktuar për secilin specialist është në përputhje me volumin e kontratës objekt prokurimi sidhe me afatet e përcaktuara në grafikun e lëvrimit. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.”

III.6.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Komisioni

sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

III.6.10. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit për kualifikim KPP vëren se për sa i përket pretendimeve të tij për profesionin *montator prodhime druri* operatori ekonomik ankimues ka qënë kontradiktor në kërkesat e tij sepse nga njëra anë shprehet se kërkesa për 4 montator prodhime druri është një kërkesë e ekzagjeruar dhe duhet ulur numri i tyre dhe nga ana tjetër shprehet se ky profesion nuk figuron në katalogun kombëtar të kualifikimeve profesionale të miratuar me Urdhërin e Minsitrit të Financave nr. 99, date 25.05.201 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale” dhe duhet hequr si kërkesë. Gjithshhesei KPP do të gjykojë së pari mbi këtë profesion sëbashku me bojaxhinj per prodhime druri sipas kërksës së ankimuesit nëse bëjnë pjesë në katalogun kombëtar te kualifikimeve profesionale apo jo dhe më pas do të gjykojë në lidhje me faktin nëse numri i kërkuar per monator për prodhime druri është në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës. Autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 të shtojcës 7 “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” të dokumentave të tenderit ndër të tjera ka kërkuar që operatorët ekonomik ofertues të kenë të punësuar në stafin e tyre 4 montator per prodhime druri dhe 1 bojaxhi per prodhime druri. Vendosijen e kësaj kërkesë për kualifikim autoriteti kontraktor e ka argumentuar, duke u bazuar në parashikimet e nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu ka hartuar kërkesat për profesionet e sipërpërmendura duke u shprehur se Marangozë dhe montator prodhime druri- pjesa me e madhe e zerave te preventivit lidhet me mobilimin te cilat do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga autoritetit kontraktor dhe bojaxhi për prodhime druri duhet pasi pjesën më të madhe të preventivit e zë mobilimi dhe për tu realizuar ngjyrat sipas përcaktimeve në projekt është parë e arsyeshme kërkesa për një bojaxhi për prodhimet e drurit. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për heqjen e kërkesave për profesionet më sipër KPP referuar Urdhërit të Minsitrit të Financave nr. 99, date 25.05.201 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale” vëren se vërtetë në këtë urdhër nuk ka në mënyrë të shprehur profesionet montator per prodhime druri dhe bojaxhi për prodhime druri por ka profesionin karpentier i cili lidhjen me LKP (listën kombëtare të profesioneve) e ka me kodin nr. 7115. Referuar VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar” në “Grupi-njësi (Profesioni): “Karpentierë/zdrukthëtarë dhe të tjerë të lidhur me to”, Kodi i profesionit: 7115 tek “Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të

Profesioneve:” kemi kodin “7115.01 Bojaxhi për dru” dhe kodin “7115.20 Montues për dru”. Sa më lart KPP vëren se për sa kohë profesionet e mësipërme gjenden në listën kombëtare të profesioneve (LKP) të miratuar me aktin nëligjor të sipërpërmendur KPP e gjen të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor për profesione të tilla dhe si rrjedhim pretendimi i ankimuesit për heqjen e tyre nuk qëndron.

Lidhur me kundërshtimet e ankimuesit duke kërkuar uljen e numrit të marangozëve, montatorëve për prodhime druri dhe saldatorëve KPP gjykon se, referuar procesvebalit të hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale kërkesën mbi një numër të tillë marangozësh, montatorësh për prodhime druri dhe saldatorësh duke u mjaftuar me argumentimin kryesisht në mënyrë narrative me bazë ligjore të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, dhe duke e lidhur kërkesën për marangozë dhe montator prodhime druri me pjesën me të madhe të zerave të preventivit që kanë të bëjnë me mobilimin të cilat do të prodhohen/asamblohen sipas permasave të kërkuara nga autoriteti kontraktor si dhe kërkesën për saldatorë për zëra të caktuar të preventivit si Riparime, prerje dhe saldim profila metalike (helmetat+predhat/gezhojat+element avjoni), (AU-DY-04) konstruksion metalik i përbërë shkallet auditor, recepsioni-struktura e avjoneve, por pa një analizë të detajuar pse është përcaktuar kërkesa për një numër të tillë profilesh të cituara më sipër. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesat në fjalë për një numër të tillë profesione janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kërkesat e mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, mallrave që do të lëvrohen si dhe afatit të lëvrimit, dhe gjithashtu punimeve që do të kryhen KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e marangozëve, montatorëve dhe të saldatorëve pasi numri i kërkuar për këto profesione është i ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi por autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve për kualifikim dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshtatjes së saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshtatur sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e lartpërmendur, duke ulur numrin e marangozëve, montatorëve për prodhime druri dhe të saldatorëve me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese. Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

Sa më lart pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK për pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit: *“Se pari, kërkesa për 3 copë mjete është një kërkesë teresisht e pa justifikuar dhe aspak e argumentuar në mënyrë analitike dhe aritmetike nga autoriteti kontraktor..... kërkojmë modifikimin e kërkesës duke e ulur numrin e mjeteve në përputhje me analizën e detajuar aritmetike dhe grafike të autoritetit kontraktor.*

.....
Së fundmi kërkesa që kapaciteti mbajtes i mjeteve të jete 3.5 ton, është një kërkesë teresisht e pa mbështetur në një analizë teknike, aritmetike dhe grafike. Në argumentin e kriterit mungon teresisht një analizë e detajuar që do të jepte autoritetit të drejtën për këtë kërkesë. Për pasojë kërkojmë uljen e tonazhit.” KPP vëren se,

III.7.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.9, është përcaktuar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë:

<i>Mjete</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamion vetëshkarkues(kapaciteti mbajtës minimumi 3.5(tre pike pesë) ton</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) *Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- b) *Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse noteriale të qerave. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

Per pikat 4-9 te KVK gjate ofertimit do te plotesohet formulari vete deklarimit Shtojca 9 , ndersa dokumentacioni provues do te paraqitet i plote nga OE i kualifikuar i pari ne vleresim, perpara njoftimit te fituesit paraprak.

III.7.2. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: **“Argumentimi:** *Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e*

Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Bazuar në analizen teknike duke pasur parasysh punimet që do të kryhen, transporti i materialeve të kërkuara të cilat janë të konsiderueshme kërkohet dhe numri i mjeteve të sipërpërmendura.”

III.7.3. Neni 2, Qëllimi i ligjit 162/2020, Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.7.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.7.5. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këto pretendime KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktitor për njohjen e gjendejs dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhe të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike makineritë/automjete), në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

KSHA gjykon se përcaktimi në kriterin e sipërcituar të llojit të kamionit vetëshkarkues është një lapsus dhe si i tillë do të modifikohet nga autoriteti kontraktor duke hequr fjalën “vetëshkarkues”. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se tonazhi i kërkuar jo më pak se 3.5 ton dhe numri i kërkuar i kamionave (3 copë) janë dy kërkesa të pambështetura apo të paargumentuara, KSHA gjykon se ato janë në përputhje me objektin e kontratës dhe dispozitave ligjore për prokurimin publik, si dhe është e nevojshme përmbushja e tyre prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në mënyrë që autoriteti kontraktor të krijojë bindjen se operatori ekonomik fitues do të mundësojë realizimin e kontratës në kohë dhe cilësi. Bazuar në analizën teknike, duke pasur parasysh punimet që do të kryhen, transporti i materialeve të kërkuara, të cilat janë të konsiderueshme, sasia e mobiljeve që do të transportohen dhe cdo element tjetër, kërkohet dhe numri i mjeteve të sipërpërmendura si një garanci e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi në kohë, standard e cilësi. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qendron pjesërisht.”

III.7.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.7.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes se. *“kerkesa per 3 cope mjete eshte nje kerkese teresisht e pa justifikuar dhe aspak e argumentuar ne menyre analitike dhe aritmetike nga autoriteti kontraktor..... kerkojme modifikimin e kerkeses duke e ulur numrin e mjeteve ne perputhje me analizen e detajuar aritmetike dhe grafike te autoritetit kontraktor.....Së fundmi kerkesa qe kapaciteti mbajtes i mjeteve te jete 3.5 ton, eshte nje kerkese teresisht e pa mbeshtetur ne nje analize teknike, aritmetike dhe grafike. Ne argumentin e kriterit mungon teresisht nje analize e detajuar qe do ti jepte autoritetit te drejten per kete kerkese. Per pasoje kerkojme uljen e tonazhit.”* Komisioni pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë tij, si dhe Procesverbalit *“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”*, konstaton, se ky i fundit, në lidhje me pikën 2.3.9, nuk ka dhënë asnjë argument teknik, se ku është bazuar në përcaktimin e numrit të mjeteve të transportit dhe tonazhit të tyre duke u mjaftuar me një shpjegim narrativ pa një analizë teknike

dhe të qartë për një kërkesë të tillë si për numrin ashtu dhe për tonazhin. Referuar kërkesave të sipërcituara, autoriteti kontraktor si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave dhe sasinë si dhe llojin e punimeve dhe volumine tyre, duke përcaktuar kriteret që përmbushin me sukses kontratën nga njëra anë por edhe lehtësojnë punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën nga ana tjetër. Akoma më tej, Komisioni thekson, se është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës ta realizojnë atë me mjete transporti në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës, operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë dhe cilësi. Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin 2.3.9, duke e modifikuar atë në lidhje me numrin dhe tonazhin e mjeteve të transportit të mallrave.

Sa më lart pretendimi i ankimesit “Klame” SHPK qëndron.

III.8. “Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimesit “Klame” SHPK, për pikën 2.3.10 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku kërkon: *“Heqjen e kërkesave per ISO 14001:2015 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme), ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, ”Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme), BS PAS 99:2012 ose ekuivalente si kërkesa qe nuk kane lidhje me objektin e tenderit.”* KPP vëren se,

III.8.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.10, është përcaktuar si më poshtë:

10. *Operatori ekonomik, duhet te deshmoje se eshte i pajisur me certifikatat:*
- *ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ”Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme);*
 - *ISO 14001:2015 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme);*
 - *ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, ”Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);*
 - *BS PAS 99:2012 ose ekuivalente , ”Per Sistemin e Menaxhimit te Integruar” (e vlefshme);*
 - *SSH UNI EN ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente , ”Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike” (e vlefshme).*

III.8.2. Në nenin 2, “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.8.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.8.4. Në nenin 77, pika 1 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.8.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe*

ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës dhe të materialeve.

III.8.6. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...] Komisioni i Shyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje me kontratën objekt prokurimi. KSHA gjykon se certifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.10 të kriterëve të kualifikimit në DT janë të nevojshme pasi ndikojnë në garantimin e AK mbi sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë procesit të prodhimit apo kryerjes së një veprimtarie, menaxhimit e cilësinë, dhe menaxhimit e mjedisit. Në këtë kuptim, duke qenë se mallrat objekt prokurimi si dhe punimet që do të kryhen kalojnë në disa faza të njëpasnjëshme gjatë prodhimit të tyre, kërkesa e certifikatave të sipër përmendura ndikojnë në cilësinë e mallravepunëve, sigurinë e puninjësve si dhe mbrojtjen e mjedisit në të gjitha këto faza.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.”

III.8.7. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti Kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt - prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që kërkon të blejë, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për heqjen e Certifikatës ISO 14001:2015 ose ekuivalente për “Sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme), KPP gjykon të ndalet në një

test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kjo kërkesë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave të kërkuara në bazë të kontratës së furnizimit që mund të dalë nga procedura e prokurimit publik por edhe realizimi me përpikmëri i volumit të punimeve sipas zërave të parashikuar në preventiv me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës dhe në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa për disponimin e certifikatës ISO 14001:2015 ose ekuivalente për “Sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) , duke qenë se kemi dhe zëra të preventivit që kanë të bëjnë me punime dhe jo vetëm furnizim mallrash, kjo certifikatë i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor prokuron arredimin/mobilimin e e Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura i cili referuar preventivit të ngarkuar në SPE nga autoriteti kontraktor ka edhe zëra punimesh për të cilat, kërkesa për ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente nuk është një kërkesë e egzagjeruar si dhe ka lidhje me objektin e prokurimit, prandaj KPP e gjen të drejtë kërkesën e autoriteti kontraktor për certifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente për “Sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) dhe si rrjedhim pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për heqjen e Certifikatës ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, ”Per Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme), KPP gjykon, se për të njëjtin arsytim që është përdorur më sipër duke qenë se në procedurën e prokurimit object ankimi përveçse kemi lëvrim mallrash referuar zërave të preventivit kemi edhe kryerje të punimeve për këtë fakt Certifikata ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, ”Per Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme), ka lidhje me objektin e prokurimit dhe i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, prandaj edhe në këtë rast KPP e gjen të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor për këtë lloj certifikate dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e certifikates BS PAS 99:2012 ose ekuivalente , ”Per Sistemin e Menaxhimit të Integruar” (e vlefshme), Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kërkesa e mësipërme, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik. Operatori ekonomik me të drejtë kundërshton këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor si të ekzagjeruar dhe që duhet të hiqet, pasi nuk i shërben objektit të prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që ato t’i shërbejnë dhe të jenë në funksion të qëllimit të objektit të procedurës së prokurimit, duke lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre. Në rastin, konkret kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës BS PAS 99:2012 ose ekuivalente , ”Per Sistemin e Menaxhimit të Integruar” (e vlefshme) është kërkesë e tepruar dhe që nuk i shërben objektit të prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e saj dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK, për pikën 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku kërkon: “[...] Shoqëria jone gjykon se kërkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vete autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të argumentuar kërkesën e kualifikimit, për pasojë kërkojmë heqjen e kërkesës së kualifikimit të referuar me sipër.” KPP vëren se,

III.9.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.11, është përcaktuar si më poshtë::

11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik “Certifikaten e Cilesise/Konformitetit” të produktit të leshuara nga organizma të vleresimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë për artikujt:

1) Karrige me rrota, certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020/A1:2022 (Mobilje zyre - Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet); SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyra - Karrige për zyra - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë); SSH EN 16139:2013/AC:2013 (Mobilje - Qëndrueshmëria, fortesia dhe siguria - Kërkesat për ndenjeset jo – shtepiake); e njevlëshme ose e perditësuar

2) Karrige student, certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) (SSH EN 1729-1:2015 Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metoda prove) e njevlëshme ose e perditësuar

3) Dollap i larte, certifikuar në përputhje me standardin DS CEN/TR 14073-1:2004; SSH EN 14073-2:2004 DS CEN/TR 14073-1:2004; SSH EN 14073-3:2004; SSH EN 14074:2004 (DS CEN/TR 14073-1:2004 Mobilje zyrash - Ruajtja e mobiljeve - Pjesa 1: Përmasat SSH EN 14073-2:2004 Mobileri për zyra - Mobileri për ruajtje - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë SSH EN 14073-3:2004 Mobileri për zyra - Mobileri për ruajtje - Pjesa 3: Metodën e provës për përcaktimin e qëndrueshmërisë dhe të rezistencës së strukturës SSH EN 14074:2004 Pajisje për zyrat - Tavolina dhe tavolina pune dhe mobileri për ruajtje - Metodën e provës për përcaktimin e rezistencës dhe kohëzgjatjen e pjesëve të lëvizshme) e njevlëshme ose e perditësuar

4) Tavoline studenti certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) (SSH EN 1729-1:2015 Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metoda prove e njevlëshme ose e perditësuar

5) Profil alumini certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 15088:2005 Alumini dhe lidhje alumini - Produkte strukturore për punime konstruktive - Kushte teknike për inspektim dhe shpërndarje

Shenim: Per te gjitha certifikatat e mesiperme, operatori ekonomik mund te paraqese certifikata ekuivalente ose te perditesuara me ato, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise.

Operatori ekonomik mund te paraqese dhe dokumentacion te njevlefshem me "Certifikaten e Cilesise/Konformitetit" te Produktit si Deklarate Konformiteti/dosje teknike e testimave me kusht qe ky dokumentacion te jete i shoqeruar me Raportin e Testimit korrespondues.

Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme per gjate periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat dhe Raportet e testimit te mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Raportet e testimit duhet te jene te leshuar nga Laboratore testimi i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Certifikata/ dokumentacioni i pikave 10 dhe 11, ne rast te BOE do te paraqitet nga anetari i BOE sipas veprimtarise qe mbulon, ndertim apo mobilim. Anetaret e BOE, sebashku duhet te plotesojne pikat e mesiperme.

III.9.2. Referuar nenit 2, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.9.3. Referuar nenit 3, "Parime të përgjithshme", të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.9.4. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.9.5. Neni 77, pika 1, “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.9.6. Neni 77 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*
- b) efikasitetit të energjisë;*
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit

III.9.7. Në VKM nr.285, datëm 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, 44 Ndryshuar me VKM 498/2024 45 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 Shtuar me VKM 498/2024 47 mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

III.9.8. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...]Komisioni i Shyrtimit të Ankesës gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje me kontratën objekt prokurimi. Në këtë kuptim si dhe duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave që kërkojnë të blihen, është e nevojshme vërtetimi nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues, i

cilësisë së këtyre materialeve apo pjesëve përbërëse të tyre duke garantuar autoritetin kontraktor për standartin e cilësisë dhe të sigurisë të mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.”

III.9.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.9.10. Referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” autoriteti kontraktor ka argumentuar kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 të dokumenteve të tenderit si vijon; “ **Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.*

Bazuar në natyrën e objektit të prokurimit i cili ka punime dhe mobilim të ambjenteve është parë e arsyeshme kërkesa si më sipër për garantimin e cilësisë së punimeve dhe mallrave objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr.9870, datë 04.02.2008 Per standartizimin ku qëllimi kryesor i vendosjes së këtij kriteri është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetite jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta për të siguruar përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë.”

III.9.11. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht shtojcës 8, konstatohet, se në pikën 2.3.11 të “Kapacitetit teknik”, kërkohet që operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion

teknik "Certifikaten e Cilesise/Konformitetit" te produktit te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise per artikujt e përcaktuar specifikesht në këtë pikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Në rastin konkret referuar pretendimeve të ankimuesit si dhe përgjigjes së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës KPP e gjen të drejtë kërkesën më sipër duke ju referuar volumit dhe përmasave të kontratës si dhe specifikes së vetë procedurës së prokurimit. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e certifikatës së Cilesise/Konformitetit te produktit te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise per mallrat e përcaktuar specifikesht në këtë pikë dhe jo për të gjithë mallrat e procedurës çfarë nuk përbën barrierë për ofertimin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Përmes këtij certifikimi, autoriteti kontraktor merr garancinë për cilësinë, sigurinë dhe përputhjen e mallrave objekt - prokurimi me standartet e kërkuara kombëtare e ndërkombëtare, pasi qëllimi i autoritetit kontraktor është siguri i një malli cilësor dhe të sigurtë si dhe realizimi me sukses i kontratës. Duke e parë në këtë këndvështrim KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor për paraqitjen e certifikatës së Cilesise/Konformitetit te produktit te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise per mallrat e përcaktuar specifikesht në këtë pikë, nuk është një kriter që kufizon konkurrencën dhe nuk është diskriminues në rradhët e operatorëve ekonomikë, prandaj KPP e gjykon të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit "Klame" SHPK nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Klame", për heqjen e kërkesës për mostra të përcaktuara në kriterin 2.3.15, të dokumenteve të tenderit, KPP vëren se,

III.10.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.15, është përcaktuar si më poshtë:

15.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër e cila duhet të jenë në përputhje me specififikimet teknike dhe duhet te dorezohen prane AK ditën dhe ne oren e hapjes se ofertave per artikujt:

- Karrige me rrota, me piston me rregullim lartësie , Karrige me dimensione Gjat=69cm, Gjer=69cm, H=117cm.

Shenim: Ne te gjitha rastet kur permendet certifikate, marke, emer i vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues/perpunues ose sipermarres pranohet edhe ekuivalent i tyre III.7.2.

III.10.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.10.3. Neni 21, pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.10.4. Në nenin 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.10.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.10.6. Referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” autoriteti kontraktor ka argumentuar kërkesën për mostra si më poshtë vijon; “**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr.162, 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (të ndryshuar). Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për zërin në preventiv karrige me rrota, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, specifikimet që ka artikulli objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara me ato të paraqitura pranë AK-së.”

III.10.7. Në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës lidhur me këtë pretendim KSHA e autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar si më poshtë:

“[...]Paraqitja e mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektin që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij. KSHA gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë në mënyrë që të jetë e garantuar cilësia e produkteve të kërkuara. KSHA gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave të kërkuara dhe përmbushjes me sukses të kontratës. Në rastin konkret KSHA gjykon të arsyeshme paraqitjen e mostrave për zërin ne preventiv karrige me rrota, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, specifikimet që ka artikulli objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara me ato të paraqitura pranë AK-së. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.”

III.10.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifikë, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.10.9. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni

konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostres për artikullin e sipërpërmendur nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet. Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret i kualifikimit i hartuara nga autoriteti kontraktor, nuk diskriminon/përjashton nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Mostrat në vetvete shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor me specifikimet teknike të vetë produktit, informacion të cilin autoriteti kontraktor mund ta arrijë edhe përmes paraqitjes së katalogëve ose skedës teknike, kërkesa të cilat autoriteti kontraktor nuk i ka parashikuar në dokumentet e tenderit prandaj kërkesa për paraqitjen e mostrës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikave të saj me specifikimet teknike në dokumentet e tenderit është një kërkesë e drejtë dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.11.Lidhur me pretendimet e ankimuesit që *“Në specifikime teknike (ankimuesi nuk ka cituar asnjërin prej zërave të preventivit) konsatojme se autoriteti kontraktor ka kerkuar permasa fikse qe kane te bejne me gjeresine,lartesine e tj te mallrave duke i orientuar operatorete ekonomik vetem ndaj nje ose disa mallrave apo prodhuesve.....kerkojme në mënyrë urgjente që të ndryshojnë specifikimet teknike duke lene hapësire edhe per permasa forma te tjera alternative te cilat realizojne te njejten cilesi, rezultat perdorimi te kerkuar.”* KPP gjykon se,

III.11.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe *“elementet e domosdoshme të ankesës”* sipas përcaktimeve të nenit 48, *“Kushtet formale të ankesës”*, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike nga autoriteti kontraktor, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se kritere/specifikime teknike të cilit prej artikujve të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të paqarta, konfuze apo jo të hartuara saktë .

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “*Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura”, me fond limit 110,154,899.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.11.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura”, me fond limit 110,154,899.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.11.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A.
 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet dhe arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe me vendimin e KSHA-së dhe t’i publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Klame” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiovent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

